

PËRCEPTIMET, SFIDAT DHE RRUGËTIMI DREJT MBROJTJES SË SHËNDETIT PUBLIK: HULUMTIMET RRETH SJELLJES SË POPULLATËS NË KOSOVË



Florie Miftari- Basholli

*Specialist i Shëndetësisë
Publike*

Përmbledhje

Në përpjekje për të përmirësuar dhe ruajtur shëndetin publik në Kosovë, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), Departamenti i Mjekësisë Sociale (DMS) në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) dhe partnerët ndërkombëtarë, ka realizuar një sërë hulumtimesh mbi perceptimet dhe qëndrimet e popullatës ndaj imunizimit, duke mbuluar periudhën e pandemisë COVID-19 dhe shtimin e vaksinës HPV në kalendarin e rregullt të vaksinimit. Rezultatet tregojnë rritje në pranueshmërinë ndaj vaksinimit si rezultat i përpjekjeve të qëndrueshme institucionale dhe fushatave vetëdijesuese. Megjithatë, keqinformimi dhe boshllëqet në njohuri mbeten sfida të rëndësishme, veçanërisht në komunitetet e ndjeshme. Hulumtimi i fundit (2023-2024) mbi faktorët që ndikojnë në sjelljet ndaj vaksinimit konfirmon rëndësinë e rolit të profesionistëve shëndetësor, familjes dhe edukimit të vazhdueshëm. IKShPK thekson nevojën për zhvillimin e hulumtimeve të rregullta, bashkëpunimin ndër sektorial, fuqizimin e kapaciteteve dhe zhvillimin e platformave për komunikim më efektiv.

Hyrja

Departamenti i Mjekësisë Sociale (DMS) në IKShPK ka mision promovimin e shëndetit dhe mirëqenies së komunitetit [1], duke punuar me vendimmarrës, profesionist dhe individ, grupe e bashkësi. DMS në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSh) dhe organizata të shumta vendore e ndërkombëtare, ka realizuar hulumtime të sjelljes së popullatës (Behavioral Insights-BI) për të kuptuar qëndrimet dhe njohuritë e qytetarëve rreth temave me interes në ruajtjen dhe përparimin e shëndetit publik, në veçanti rreth vaksinimit. Këto hulumtime, që përfshijnë periudhën e pandemisë COVID-19, duke filluar nga viti 2020 dhe periudhën e inkorporimit të vaksinës HPV në kalendarin e rregullt të vaksinimit në vitin 2024, kanë

prodhuar evidenca të vlefshme për planifikimin dhe zbatimin e fushatave të komunikimit dhe edukimit shëndetësor. Grupet e synuara të përfshira në hulumtime ishin grupet e ndjeshme dhe të rrezikuara të popullatës (profesionistët shëndetësor, personat e moshuar, prindërit, fëmijët dhe të rinjtë), personat që jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike, komunitetet.

Java botërore e imunizimit këtë vit në Kosovë nën moton “Imunizimi është i mundur për të gjithë” [2], ka shërbyer si platformë për të reflektuar mbi përparimin dhe rëndësinë e vaksinimit për shëndetin individual dhe kolektiv.

Qëllimi i këtij punimi është të prezantohen sfidat dhe perceptimet e popullatës lidhur me imunizimin në Kosovë.

Materiali dhe metodologjia

Metodologjia e përdorur ishte gjithëpërfshirëse dhe përfshinte komponentët kuantitativ dhe kualitativ, duke siguruar një pasqyrë të plotë dhe të balancuar të faktorëve që ndikojnë në vendimmarrjen për imunizim në kontekstin e Kosovës.

Hulumtimi i BI gjatë COVID-19 është zhvilluar duke përdorur metodologjinë cross-sectional, të organizuar në formë valësh të njëpasnjëshme të mbledhjes së të dhënave, gjatë periudhës tetor 2020 - korrik 2021. Qasja e përdorur ka mundësuar vlerësimin e qëndrimeve dhe praktikave në kohë reale ndaj sfidave shëndetësore, me fokus të veçantë në pandeminë COVID-19 dhe vaksinimin HPV. Çdo valë e hulumtit ka përfshirë të paktën 1000 respondentë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme dhe reprezentative, me kriteret përfshirjeje si: moshë mbi 18 vjeç, shtetësi kosovare, përfaqësim i balancuar gjinor (gr/burra), banimi (urban/rural), edukimi dhe grup moshë. Intervistat janë kryer duke përdorur metodën Computer Assisted Telephone Interviews (CATI) nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) në bashkëpunim me kompaninë INDEX Kantar



Figura 1. Infografikat e hartuara për komunitetet e ndjeshme të popullatës gjatë fushatës “Bashkë kundër COVID-19”, janar-mars 2021.

Korrespondenca:
florie.miftari.basholli@rks-gov.net

PËRCEPTIMET, SFIDAT DHE RRUGËTIMI DREJT MBROJTJES SË SHËNDETIT PUBLIK: HULUMTIMET RRETH SJELLJES SË POPULLATËS NË KOSOVË



Merita Berisha

*Specialist i Mjekësisë Sociale/
Shëndetësisë Publike*

Kosova.

Hulumtimi i tërthortë për vaksinimin e rregullt u zhvillua nga rrjeti bashkëpunues i përbërë nga Euro Health Group (EHG), UNICEF Kosova, Zyra e OBSH-së në Kosovë, dhe kompania Index Kantar, nën mbikëqyrjen e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe UNICEF ECARO (Zyra për Evropë dhe Azinë Qendrore) gjatë vitit 2023-2024. Anketimet u zhvilluan duke përdorur metodën Computer-Assisted Personal Interviewing (CAPI), e cila ka siguruar mbledhjen e të dhënave të standardizuara dhe të qëndrueshme. Për prindërit/kujdestarët u përdorë një mostër shumëfazore e rastësishme dhe e stratifikuar, me komunat si njësi primare të përzgjedhjes. Mostra siguroi përfaqësim të balancuar demografik sipas vendbanimit, gjinisë dhe statusit socio-ekonomik. Ndërkaq, për profesionistët shëndetësor, u përzgjedhën mjekë dhe infermierë që janë drejtpërdrejt të përfshirë në imunizimin e fëmijëve.

Komponentët shtesë kualitative të hulumtimeve

Për të thelluar kuptimin mbi perceptimin e vaksinimit me vaksinën HPV dhe vaksinat e kalendarit të rregullt, në metodologjinë e hulumtimeve janë inkuorporuar edhe komponentët kualitative, që kanë përfshirë: punëtoritë me grupet e interesit, intervistat individuale dhe diskutimet në fokus grupe. Këto komponentë janë përdorur për të eksploruar qëndrimet, barrierat dhe nxitësit ndaj imunizimit, në kuadër të një qasje të strukturuar sipas Modelit të faktorëve nxitës të sjelljes (Behavioral Drivers Model - BDM).

Hulumtimi "Behavioral Insights/ Monitorimi i njohurive, perceptimet e rrezikut, sjelljet parandaluese dhe besimi për të informuar reagimin ndaj shpërthimit të pandemisë së COVID-19 në Kosovë" realizuar për herë të parë në vend dhe në rajon nga muaji shtator 2020 deri në tetor të vitit 2022, përfshinte: njohuritë shëndetësore, gjendjen financiare, sjelljet negative pandemike, besimin në institucionet shtetërore, përkrahjen e masave parandaluese, perceptimet dhe sjelljet ndaj vaksinës kundër COVID-19.

"Hulumtimi i shpejtë kualitativ informues për prezantimin e vaksinës HPV", i realizuar gjatë vitit 2023 dhe "Vlerësimi: Njohuritë mbi zhvillimin dhe zbatimin e planit të komunikimit dhe intervenimit për prezantimin e vaksinës HPV", i realizuar gjatë vitit 2024, gjeneruan rezultate në lidhje me keqinformimin për vaksinimin në Kosovë para dhe pas shtimit të vaksinës HPV në kalendarin e rregullt të vaksinimit. Të dhënat u mblodhën përmes diskutimeve në fokus grupe dhe intervista të thella me profesionistët shëndetësor, mësimdhënësit, drejtorët e shkollave, gazetarët, influencuesit,

prindërit e vajzave 12 vjeçare, vajzat 12 vjeçare, përfaqësuesit e komunitetit dhe Organizatat jo qeveritare (OJQ).

"Hulumtimi mbi faktorët që ndikojnë në sjelljet ndaj vaksinimit në Kosovë (2023-2024)" është realizuar nga DMS/IKShPK me mbështetjen nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe OBSH. Modeli Behavioral Drivers është përdorur për dizajnim të protokollit të hulumtimit dhe janë realizuar anketimet në dy mostra me prindër/kujdestarë dhe profesionistët shëndetësor.

Rezultatet kryesore

Nga hezitimi tek pranimit - Mësimet nga pandemia COVID-19

Kosova kishte sfida të ndryshme gjatë përbaljes me pandeminë e COVID-19, me një sistem shëndetësor të brishtë dhe jo të gatshëm për ballafaqim me situatën e re globale.

Në kulmin e pandemisë COVID-19, perceptimet e popullatës ishin të ndikuara nga dezinformata, mosbesimi dhe paqartësitë lidhur me vaksinimin. Megjithatë, përmes gjashtë valëve të hulumtimit të realizuara, është vërejtur një përmirësim i ndjeshëm i perceptimeve të popullatës. Rezultatet tona treguan se në valën e pestë të hulumtimit, përqindja e atyre që thanë se definitivisht nuk do të vaksinohen kishte rënë në 13% krahasuar me 53% në valën e parë.

Sfida të reja me inkuorporimin e vaksinës kundër Human Papilloma Virusit (HPV) në kalendarin e rregullt

"Hulumtimi i shpejtë kualitativ informues për prezantimin e vaksinës HPV", i realizuar gjatë vitit 2023 dhe "Vlerësimi: Njohuritë mbi zhvillimin dhe zbatimin e planit të komunikimit dhe intervenimit për prezantimin e vaksinës HPV", i realizuar gjatë vitit 2024, janë kryer në bashkëpunim të ngushtë me MSh dhe me përkrahje nga Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) në Kosovë dhe Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) për Evropë në Kopenhagë.

Rezultatet e hulumtimeve treguan se si keqinformimet - si miti se "vaksinat përmbajnë substanca të dëmshme", "vaksinat shkaktojnë sëmundje", apo "besimi se një fëmijë i shëndetshëm nuk ka nevojë për vaksinim" - vazhdojnë të paraqesin pengesë për pranueshmërinë e vaksinave. Disa profesionist shëndetësor kishin mungesë informacioni të saktë, keqinformimi i zakonshëm përfshinte atë që: "vaksina MMR shkakton autizëm" apo "shqetësimet lidheshin me përbërësit e vaksinës" (p.sh., përmbajtja e merkurit). Disa nga mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave gjithashtu treguan boshllëqe në njohuri mbi vaksinat, veçanërisht vaksinën MMR dhe

PËRCEPTIMET, SFIDAT DHE RRUGËTIMI DREJT MBROJTJES SË SHËNDETIT PUBLIK: HULUMTIMET RRETH SJELLJES SË POPULLATËS NË KOSOVË



Ardita Baraku

*Specialist i Shëndetësisë
Publike*

vaksinës HPV, dhe u ndikuan nga: profesionistët shëndetësor, prindërit, rrjetet e diasporës që përhapnin dezinformata (p.sh., lidhja e vaksinës MMR me autizmin).

Komunitetet minoritare (si romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët) ishin veçanërisht të ndjeshëm ndaj dezinformatave për shkak të barrierave në shkrim-lexim dhe qasjes në informim të saktë.

Përceptimet aktuale dhe rekomandimet për të ardhmen

“Hulumtimi mbi faktorët që ndikojnë në sjelljet ndaj vaksinimit në Kosovë (2023-2024)” i realizuar nga DMS/IKShPK me mbështetjen nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) dhe OBSH kishte për qëllim identifikimin e faktorëve psikologjik, sociologjik dhe mjedisor që ndikojnë në sjelljet e vaksinimit tek prindërit dhe profesionistët shëndetësor.

Shumica e prindërve dhe profesionistëve shëndetësor shfaqin qëndrim pozitiv ndaj efikasitetit dhe sigurisë së vaksinave. Megjithatë, ekziston ende dyshim për vaksina të caktuara si vaksina MMR dhe lidhjen e saj të pabazuar me autizmin. Prindërit mbështeten më së shumti tek mjekët pediatër dhe familja për vendimmarrje, ndërsa platformat sociale cilësohen si burime më pak të besueshme.

Diskutimi

Niveli i pranimi të vaksinimit në Kosovë ndikohet nga një sërë faktorësh që lidhen me perceptimin e riskut, besueshmërinë ndaj sistemit shëndetësor, dhe qasjen në informacion të saktë. Studimi i realizuar përmes valëve të hulumtimit tregon se nxitësit kryesor për pranimin e vaksinimit janë: kujdesi për shëndetin e fëmijëve, rekomandimi i profesionistëve shëndetësor, si dhe fushatat e ndërgjegjësimi të mbështetura nga institucionet publike dhe organizatat ndërkombëtare si UNICEF dhe OBSH.

Në të kundërtën, barrierat kryesore përfshijnë mungesën e informacionit të besueshëm, dezinformimin në media, hezitimin ndaj vaksinave të reja (si HPV), dhe mungesën e edukimit shëndetësor, sidomos në zonat rurale. Mungesa e dialogut efektiv midis mjekëve dhe komunitetit, si dhe perceptimi i ulët i rrezikut për COVID-19 pas fazave fillestare të pandemisë, kanë ndikuar negativisht në mbulueshmërinë vaksinore.

Studimet e kryera në vendet evropiane treguan se nxitësit dhe barrierat për pranimin e vaksinimit kundër COVID-19 [3,4,5], HPV [6,7] dhe vaksinave të kalendarit të rregullt të imunizimit janë të ndërlikuara dhe të ndikuara nga faktorë të ndryshëm psikologjik, social dhe institucional.

Studimet tregojnë se rekomandimet e mjekëve dhe infermierëve janë ndër faktorët më të

rëndësishëm që ndikojnë në vendimin për t'u vaksinuar [8]. Ndërgjegjësimi për rëndësinë e vaksinimit, si fushatat vetëdijesuese dhe informuese kanë ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimi për rëndësinë e vaksinimit, veçanërisht për vaksinën HPV. Mungesa e informacionit të saktë dhe të besueshëm është një nga pengesat kryesore për pranimin e vaksinimit në Evropë [8,9]. Përhapja e dezinformimit dhe teorive konspirative, veçanërisht në rrjetet sociale, ka ndikuar negativisht në qëndrimet ndaj vaksinimit. Mungesa e besimit në autoritetet shëndetësore dhe në sigurinë e vaksinave është një tjetër faktor që kontribuon në hezitimin ndaj vaksinimit [10].

Hulumtime të vazhdueshme për analizimin e perceptimeve të popullatës

Rezultatet e valës së parë dhe të dytë të hulumtimit gjatë COVID-19 ofruan evidenca mbi të cilat janë dizajnuar aktivitetet dhe materialet promovuese në kuadër të fushatës vetëdijesuese «Bashkë kundër COVID-19» realizuar nga IKShPK/MSH, me përkrahje të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT), Fondacionit të Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA), UK Aid, Asociacionit të Komunave të Kosovës. Vendi ynë kishte një model të ngjashëm me hezitim fillestar që u zëvendësua nga shkallë më të larta pranimi përmes përpjekjeve të qëndrueshme të shëndetësisë publike. Ky ndryshim iu atribuua përpjekjeve të qëndrueshme të institucioneve publike dhe partnerëve ndërkombëtarë për të luftuar keqinformimin dhe infodeminë.

Rezultatet e dy hulumtimeve kualitative BI më tutje, janë shfrytëzuar si evidenca dhe referenca mbi të cilat janë hartuar aktivitetet në kuadër të “Planit të avokimit, komunikimit dhe mobilizimit social për vaksinat e reja në kalendarin e vaksinimit”. Kjo ka sjellë zbatim më të suksesshëm të vaksinave të reja të kalendarit të vaksinimit.

Ndërsa hulumtimi i tretë ka ndihmuar në fitimin e njohurive si nga profesionistët ashtu edhe nga mësime të mëdha dhe prindërit.

Në përballje me sfidat komplekse të shëndetit publik, përfshirë pandemitë, dezinformimin dhe hezitimin ndaj vaksinimit, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) ka identifikuar një sërë prioritetesh kyçe si udhërrëfyes strategjik që synojnë fuqizimin e sistemit të informuar dhe gjithëpërfshirës të çështjeve të ndërlidhura me shëndetin publik, në veçanti me imunizimin.

Rritja e bashkëpunimit ndërsektorial

Imunizimi nuk është vetëm përgjegjësi e sektorit shëndetësor. Bashkëpunimi ndërsektorial - që përfshin arsimin, mediat, organizatat e shoqërisë civile, autoritetet lokale dhe liderët komunitar - është thelbësor për të ndërtuar një qasje

Korrespondenca:
ardita.baraku@rks-gov.net

gjithëpërfshirëse dhe efektive. Roli i shkollave, mediave të përgjegjshme dhe organizatave rinore mund të jetë vendimtar në krijimin e një kulture dhe edukimi rreth vaksinimit dhe procesit të imunizimit.

Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe sistemit të informimit publik

Investimi në fuqizimin profesional të profesionistëve shëndetësor, si dhe përmirësimi i sistemit të informimit publik, janë dy shtylla të domosdoshme për suksesin afatgjatë të programeve të imunizimit. Trajnimet periodike, qasja në literaturë shkencore të përditësuar dhe përkrahja institucionale i ndihmojnë profesionistët të përballojnë dezinformatat dhe të rrisin besimin te publiku. Në të njëjtën kohë, transparenca dhe qasja në informacione të besueshme për qytetarët duhet të jenë prioritet i përhershëm.

Promovimi dhe edukimi shëndetësor përmes platformave të përshtatshme

Përdorimi i platformave të ndryshme mediale - si rrjetet sociale, portalet informative, podcast-et dhe aplikacionet mobile - për të transmetuar mesazhe të qarta, të sakta dhe të përshtatura për grupe të ndryshme demografike, është një strategji moderne dhe e domosdoshme. Materialet vizuale, videot edukative, tregimet nga individë të vaksinuar, ndarja e përvojave personale dhe ndërveprimi me figura publike pozitive mund të luajnë një rol të rëndësishëm

në thyerjen e miteve dhe ndërtimin e besimit.

Përfundimi

Kosova ka treguar se rezultatet e hulumtimeve BI që janë shfrytëzuar për hartim të politikave, kanë rezultuar në angazhim të shtuar institucional, përfshirje të rritur të komunitetit dhe kanë mundësuar të kapërcehen sfidat që shoqërojnë procesin e imunizimit.

Për të kuptuar pse individët dhe komunitetet hezitojnë, pranojnë ose refuzojnë vaksinimin, është thelbësore që IKShPK të vazhdojë me hulumtime të rregullta dhe multidisiplinore. Hulumtimet duhet të thellohen në faktorët psikologjik, kulturor dhe socio-ekonomik që ndikojnë në sjelljet rreth vaksinimit. Vetëm përmes një analize të tillë, politikbërja dhe fushatat vetëdijesuese mund të përshtaten realisht me nevojat dhe shqetësimet e popullatës dhe grupeve të cënueshme të saj.

Rënia e hezitimit ndaj vaksinimit gjatë pandemisë COVID-19 dhe pranimi në rritje i vaksinës HPV janë dëshmi e suksesit të qasjes së bazuar në evidencë dhe bashkëpunim. Kjo rrugë e ndërtuar me përkushtim dhe vendosmëri duhet të vazhdojë, me qëllim që çdo fëmijë, prind dhe qytetar të ndihet i mbrojtur përmes një sistemi të fuqishëm të imunizimit - një hap vendimtar drejt një të ardhmeje më të shëndetshme dhe më të barabartë për të gjithë.

Referencat:

- 1.Mjekësia Sociale, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, Web page: <https://niph-rks.org/mjekesia-sociale/>.
- 2.Campaigns/World Immunization Week 2025/World Health Organization, Web page: <https://www.who.int/campaigns/world-immunization-week/2025>.
- 3.Manolescu LS, Zaharia CN, Dumitrescu AI, Prasacu I, Radu MC, Boeru AC, Boidache L, Nita I, Neculescu A, Medar C, Cristache CM. COVID-19 parental vaccine Hesitancy in Romania: nationwide cross-sectional study. *Vaccines*. 2022 Mar 23;10(4):493.
- 4.Kaur M, Coppeta L, Olesen OF. Vaccine hesitancy among healthcare workers in Europe: a systematic review. *Vaccines*. 2023 Oct 28;11(11):1657.
- 5.Steinert JI, Sternberg H, Prince H, Fasolo B, Galizzi MM, Büthe T, Veltri GA. COVID-19 vaccine hesitancy in eight European countries: Prevalence, determinants, and heterogeneity. *Science advances*. 2022 Apr 27;8(17):eabm9825.
- 6.Karafillakis E, Simas C, Jarrett C, Verger P, Peretti-Watel P, Dib F, De Angelis S, Takacs J, Ali KA, Celentano LP, Larson H. HPV vaccination in a context of public mistrust and uncertainty: a systematic literature review of determinants of HPV vaccine hesitancy in Europe. *Human vaccines & immunotherapeutics*. 2019 Aug 3.
- 7.López, N., Garcés-Sánchez, M., Panizo, M.B. et al. HPV knowledge and vaccine acceptance among European adolescents and their parents: a systematic literature review. *Public Health Rev* 41, 10 (2020). <https://doi.org/10.1186/s40985-020-00126-5>.
- 8.Achimaş-Cadariu T, Paşca A, Jiboc NM, Puia A, Dumitraşcu DL. Vaccine hesitancy among european parents- Psychological and social factors influencing the decision to vaccinate against HPV: A systematic review and meta-analysis. *Vaccines*. 2024 Jan 26;12(2):127.
- 9.Alarcão V, Zdravkova B. Attitudes and practices towards HPV vaccination and its social processes in Europe: an equity-focused scoping review. *Societies*. 2022 Sep 18;12(5):131.
- 10.Kumar S, Shah Z, Garfield S. Causes of vaccine hesitancy in adults for the influenza and COVID-19 vaccines: a systematic literature review. *Vaccines*. 2022 Sep 13;10(9):1518.